


01-341



Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Dt.21.06.2016, nenit 17 pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391, dt. 25.02.2010, dhe në bazë të Vendimit nr.782/18 dt.21.02.2020 të Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit – MIA mbi obligimin e anulimit të Vendimit 05 nr.350/02 – 0222986/17 dt.2012.2019 të Drejtorisë së Urbanizmit, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 12.03.2020 merr këtë:

V E N D I M
MBI ANULIMIN E VENDIMIT 05 NR.350/02 – 0222986/17 DT.2012.2019

ANULOHET Vendimi i Kushteve Ndërtimore me 05nr.350/02 - 0222986/17 dt.20.12.2019, të lëshuar nga kjo Drejtori, me të cilat janë caktuar kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e shtatëmbëdhjetë (17) shtëpive individuale të banimit, me etazhitet B+P+1, në kuadër të parcelave kadastrale me 578-2, 603-3, 603-2, 603-5 dhe 603-6 ZK Zllatar.

A r s y e t i m

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit - MIA e Republikës së Kosovës, përmes shkresës së protokolluar 05nr.036/02-43302/20 dt. 24.02.2020 dhe dërguar në Komunën e Prishtinës – Drejtorin e Urbanizmit Vendimin nr.782/18 dt.21.02.2020, me të cilin vendim ka obliguar Komunën e Prishtinës që të anuloj Vendimin 05 nr.350/02 – 0222986/17 dt.20.12.2019, me të cilin janë caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e shtatëmbëdhjetë (17) shtëpive individuale të banimit, me etazhitet B+P+1, në kuadër të parcelave kadastrale me 578-2, 603-3, 603-2, 603-5 dhe 603-6, ZK Zllatar dhe ka obliguar që të përcillen procedura bazuar në rregullativat dhe afatet ligjore në fuqi sipas arsytimit të dhënë në vendim;

Drejtoria e Urbanizmit pas pranimit të vendimit të lartë cekur dhe konsultimit të përmbajtjes së sajë, si dhe duke u bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht pikës 1. të nenit 53 të LPPA-së nr. 05/L-031 dt. dt.21.06.2016, vendosi që Vendimin e kushteve ndërtimore 05NR.350/02-0222986/17 DT. 20.12.2019 të lëshuara nga kjo drejtori për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e shtatëmbëdhjetë (17) shtëpive individuale të banimit, me etazhitet B+P+1, në kuadër të parcelave kadastrale me 578-2, 603-3, 603-2, 603-5, 603-6, ZK Zllatar, ti ANULOJ;

Bazuar në konstatimet e prezantuara, kjo drejtori vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MIA-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj Drejtorie, Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit-MIA e Republikës së Kosovës, në dosjen e lëndës dhe Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR.036/02 – 43302/20 DT. 12.03.2020

Zyrtari,
 Florim Krasniqi



U.D. Udhëheqëse Sektori,
 Mimoza Berisha Prestreshi

